



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 111, datë 06.06.2019

PËR

**MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE TË RREGULLORES NR. 23, DATË 26.02.2018 “PËR
REGJISTRIN ELEKTRONIK ONLINE TË SHITJEVE TË KONTRATAVE TË
SIGURIMIT TË DETYRUESHËM MOTORIK”**

Në bazë dhe për zbatim të neneve 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si edhe pikës 1, germa “c”, pikave 2 dhe 5 të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimeve të Rregullores nr. 23, datë 26.02.2018 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Departamenti i Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve, për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI

Ndryshimet e Rregullores nr. 23, datë 26.02.2018 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik” i ndryshuar, sipas tekstit më poshtë:

Neni 3, riformulohet si më poshtë:

“Kjo rregullore është e detyrueshme për t’u zbatuar nga shoqëritë e sigurimit, agjentët/shoqëritë e agjentëve, punonjësit e shoqërive të sigurimit, si dhe në rast kërkese nga brokerat/shoqëritë e brokerimit, të licencuar nga AMF për të ushtruar veprimtari në klasat që lidhen me sigurimin e detyrueshëm.”

Në nenin 4, pika “1., shtohet togfjalëshi:

“... si dhe polica e sigurimit të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik.”

Në nenin 8, shtohet pika 9, si më poshtë:

“Shoqëritë e sigurimit nëpërmjet punonjësve të autorizuar, duhet të mbështesin procesin e shitjes së policave duke konfiguruar në sistemin/portalin e AMF rastet e mjeteve të zhdoganuara apo rëndësie të vecante si dhe ID të huaja apo NIPT e OJF sipas procedurës në Aneksin 6 bashkëngjitur kësaj rregulloreje.”

Ndryshimet e Aneksit 3 dhe 5 si dhe shtimi i Aneksit 6.